



## RREGULLORE

# KONKURSI I IDEVE TË BIZNESIT

(EDICIONI 2, VITI 2022)

Konkursi i Ideve të Biznesit, organizuar nga B4Students, program i Grupit BALFIN, synon të kontribuojë në nxitjen, krijimin dhe zhvillimin e sipërmarrjeve të reja nga studentët në Shqipëri.

B4Students është program i krijuar për studentët, me mbështetjen teknike dhe financiare të Grupit BALFIN në kuadër të vizionit për përgjegjësinë sociale, me fokus edukimin.

Konkursi i Ideve të Biznesit i dedikohet studentëve të ciklit Bachelor, Master Profesional dhe Master i Shkencave në Institucione të Arsimit të Lartë, Publik dhe Privat, në Shqipëri.

B4Students është përgjegjës për organizimin e Konkursit të Ideve të Biznesit.

### Konkursi i Ideve të Biznesit ka si qëllim:

- Të ofrojë mbështetje për ndërtimin e bizneseve të reja nga studentët në Shqipëri.
- Të promovojë punësimin dhe vetëpunësimin e studentëve në Shqipëri.
- Të kontribuojë në zhvillimin e aftësive sipërmarrëse të studentëve.
- Të garantojë financim në hapat e parë të biznesit.

### Përfimet e studentëve pjesëmarrës

- Mundësi për të fituar grant deri në masën 5000 euro për projekt/aplikim;
- Mundësi për kreditim me kushte preferenciale në Tirana Bank,
- Paketë trajnimi për zhvillimin e kompetencave në biznes;
- Mundësi ekspozimi me BALFIN, si investitor potencial;
- Follow-up dhe mentorim në hapat e parë të biznesit;
- Rrjetëzim me kompanitë partnere të programit.

### Informacion rreth grantit

Madhësia e grantit do të jetë deri në 5000 (pesë mijë) Euro për ide/projekt.

- Përfitues të grantit janë vetëm aplikuesit me statusin student, banues në Shqipëri.
- Vlera e grantit për ide/projekt, përcaktohet rast për rast, me vendim nga Juria.
- Studentët kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se një ide biznesi.

### Juria e konkursit

Juria, si rregull, përbëhet nga të paktën 3 (tre) anëtarë/ përfaqësues nga Grupi BALFIN.

### Afati dhe procesi i aplikimit

**Thirrja 1:** Aplikimet mbyllen më datë **7 mars 2022**.

Aplikimi, individual apo në grup, kryhet online përmes platformës [www.b4students.com](http://www.b4students.com)

Formulari i aplikimit mund të plotësohet në gjuhën shqipe ose angleze.

## Fazat e konkurrimit

**Faza 1** | brenda 7 mars 2022: Plotësimi i formularit të aplikimit me idenë e biznesit.

**Faza 2** | brenda 30 prill 2022: Organizimi i trajnimeve tematike për biznesin me aplikantët.

**Faza 3** | brenda 3 maj 2022: Dërgimi i projektit të rishikuar sipas formatit të B4Students.

**Faza 4** | 5 maj 2022: Aplikantët e përzgjedhur ftohen të prezantojnë planin përpara jurisë.

## Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikantëve

Të gjitha aplikimet vlerësohen në 3 (tre) faza, si më poshtë:

### Faza 1: Kontrolli administrativ

- Formulari i aplikimit me idenë e biznesit është dërguar brenda afatit të thirrjes.
- Informacioni i kërkuar në formularin e aplikimit është i plotë dhe i saktë.

### Faza 2: Përzgjedhja e projekteve për prezantim

- Studentët që kualifikohen në fazën e kontrollit administrativ të aplikimeve, ftohen të ndjekin disa trajnime përgatitore. Trajnimet kanë si qëllim t'i vijnë në ndihmë aplikantëve në zhvillimin e njohurive dhe kompetencave sipërmarrëse, si dhe të strukturojnë idenë e biznesit në një format plan biznesi, sipas modelit të B4Students.
- Dërgimi i planit të biznesit duhet kryer nga aplikantët **brenda datës 3 maj 2022**.
- Plani i biznesit dërgohet me email në adresën [hello@b4students.com](mailto:hello@b4students.com).

### Faza 3: Vlerësimi përfundimtar i ideve/planeve të biznesit nga juria

Aplikantët që do kalojnë fazën e përzgjedhjes (nr. 2), do të ftohen të prezantojnë planin e biznesit, në një **“Demo Day”**, përpara jurisë së Konkursit të Ideve të Biznesit. Kohëzgjatja e prezantimit përpara jurisë nga aplikanti është **7 minuta**. Numri i aplikantëve të kualifikuar vlerësohet nga Juria. Aplikantët informohen paraprakisht për detajet e aktivitetit “Demo Day”.

Vendimi për dhënien ose jo të grantit, miratohet rast për rast, me shumicë votash dhe nënshkruhet nga anëtarët e jurisë. Vendimi i jurisë i komunikohet aplikantëve në përfundim të të gjitha prezantimeve. Fituesit promovohen në website dhe në media sociale të B4Students.

Secili prej aplikantëve të “Demo Day” pajisjet me certifikatë vlerësimi nga B4Students.

### Kriteret e vlerësimit të idesë/planit të biznesit

- Vlera e krijuar në treg nga produkti i ofruar (deri në 15 pikë)
- Avantazhi konkurrues i biznesit të propozuar (deri në 15 pikë)
- Qëndrueshmëria operationale dhe teknologjike (deri në 15 pikë)
- Aftësia e themeluesit / eve dhe ekipit menaxhues (deri në 15 pikë)
- Buxheti, kërkesat për kapital dhe parashikimi financiar (deri në 20 pikë)
- Niveli i prezantimit përpara jurisë së konkursit (deri në 20 pikë)

## Dokumentacioni i aplikantëve fitues

Secili prej aplikantëve të përzgjedhur nga juria si fitues të Konkursit të Ideve të Biznesit, ka detyrim të dorëzojë e nënshkruajë dokumentacionin e mëposhtëm, **brenda muajit maj 2022**:

- 1) Aneks – Vërtetim Studenti nga Aplikant-i(ët);
- 2) Aneks – Formulari i Vetëdeklarimit të Aplikant-it(ëve);
- 3) Aneks – Fotokopje e Kartës së Identitetit ose Pasaportës të Aplikant-it(ëve);
- 4) Aneks – Rregullore e Konkursit të Ideve të Biznesit nga B4Students;
- 5) Aneks – Projekti / Plani i Biznesit sipas formatit të B4Students;
- 6) Aneks – Kopje e Ekstraktit të Biznesit të regjistruar;
- 7) Aneks – Vërtetim Llogarie Bankare të biznesit;
- 8) Aneks – Plani i Lëvrimin të Grantit.

## Lëvrimi i grantit

Vlera e miratuar e grantit nga juria është pjesë e Kontratës së Sponsorizimit, e cila lidhet mes palëve, brenda muajit maj 2022. Nëse aplikanti fitues, nuk respekton afatin e përcaktuar, humbet të drejtën për të përfituar grantin, e përcaktuar dhe komunikuar në “Demo Day”.

Granti lëvrohet, si rregull, me 3 këste: a) faza 1 – 30% brenda 10 ditësh nga nënshkrimi i kontratës dhe lëshimi i faturës së parë të fiskalizuar; b) faza 2 – 30% brenda 40 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, dhe c) faza 3 – 40% brenda 60 ditësh nga nënshkrimi i kontratës.

Disbursimi i kësteve për fazën 2 dhe 3 do të kushtëzohet me aprovim paraprak nga B4Students në varësi të vlerësimit të ecurisë së biznesit nga aplikanti dhe vërtetimi i përdorimit të grantit.

Aplikantët janë të detyruar të raportojnë ecurinë e biznesit pranë B4Students, në fund të çdo muaji, për të paktën 6 muajt e parë të aktivitetit.

## Mentorimi i aplikantëve

B4Students angazhon një profesionist me përvojë si mentor në 6 muajt e parë të aktivitetit.

## Pyetje?

hello@b4students.com  
+355 69 981 1925 (WhatsApp)

**ANEKSI 1**  
**VËRTETIM STUDENTI NGA APLIKANT-I(ËT)**

(bashkëlidhur)

**ANEKSI 2**  
**FORMULARI TIP I VETËDEKLARIMIT TË APLIKANT-IT(ËVE)**

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, me numër personal të Kartës së Identitetit/  
Pasaportës \_\_\_\_\_ në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë, deklaroj këtu se:

- Kam lexuar dhe kuptuar udhëzimet në lidhje me Konkursin e Ideve të Biznesit, organizuar nga B4Students me mbështetjen e BALFIN Group.
- Deklaroj se informacioni i përfshirë në aplikim, së bashku me çdo deklaratë të shprehur është, në dijeninë time, i vërtetë, i saktë dhe i plotë.
- Nuk jam në hetim, procedim penal apo dënuar për ndonjë veprë penale nga institucionet e drejtësisë në Shqipëri.

**Emër Mbiemër, Firma e Aplikantit**

\_\_\_\_\_

**Data**

\_\_\_\_.\_\_\_\_.\_\_\_\_\_

**ANEKSI 3**  
**FOTOKOPJE E KARTËS SË IDENTITETIT OSE PASAPORTËS TË APLIKANT-IT(ËVE)**

(bashkëlidhur)

**ANEKSI 4**  
**RREGULLORJA E KONKURSIT TË IDEVE TË BIZNESIT NGA B4STUDENTS**

(bashkëlidhur)

ANEKSI 5  
PROJEKTI/PLANI I BIZNESIT SIPAS FORMATIT TË B4STUDENTS

(bashkëlidhur)

# PLANI I BIZNESIT

## [EMRI I PROJEKTIT]

### TABELA E PËRMBAJTJES

1. Informacioni i përgjithshëm
2. Prezantim i subjektit propozues
3. Industria dhe sektori operues
4. Përshkrimi dhe analiza e projektit
5. Aspekti rregullator dhe ligjor
6. Analiza financiare
7. Përfundime



## 1. Informacioni i përgjithshëm

1.1 Misioni i projektit

1.2 Metodologjia e përdorur për përpilimin e planit të biznesit

## 2. Prezantim i subjektit propozues/investues

Të dhënat e aplikantit-ëve / themeluesit-esve

- Emër Mbiemër
- Institucioni i Arsimit të Lartë
- Programi i studimit
- E-mail
- Cel

## 3. Industria/Sektori

3.1 Përshkrimi i përgjithshëm i industrisë

3.2 Përshkrim i përgjithshëm i sektorit dhe nënsektorëve

3.3 Kërkesa dhe oferta në treg

3.4 Konkurentët direkt dhe indirekt

3.5 Vlerësimi i çmimit/ëve të shitjes dhe pozicionimi në treg

3.6 Oferta e ardhshme

## 4. Përshkrimi dhe Analiza e Projektit

4.1 Përshkrim i detajuar i projektit

4.2 Karakteristikat fizike të pronës/software-it/etj (në varësi të propozimit)

4.3 Impakti mjedisor dhe social

4.4 Analiza SWOT

## 5. Aspekti Rregullator dhe Ligjor

5.1 Forma e organizimit të biznesit

5.2 Lejet/Licencat e nevojshme për implementimin e projektit

## 6. Analiza Financiare

6.1 Investimi fillestar

6.2 Kostot

6.3 Të ardhurat

6.4 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e rrjedhjes së parasë

6.5 Analiza financiare e investimit (Kthimi i Investimit, NPV, IRR, etj)

6.6 Vlerësimi i Analizës Financiare

## 7. Përfundime

\*Kriteret që duhet të plotësohen:

1. Gjuha e përdorur duhet të jetë sa më koncize, jo metaforike
2. Përdorimi i referencave është plus
3. Format i dokumentit duhet të jetë: Margins 1 (top, down, right, left), 12 font-size

**ANEKSI 6**  
**KOPJE E EKSTRAKTIT TË BIZNESIT NGA PËRFITUESI**

(bashkëlidhur)

**ANEKSI 7**  
**VËRTETIM LLOGARIT BANKARE TË PËRFITUESIT**

(bashkëlidhur)

**ANEKSI 8**  
**PLANI I LËVRIMIT TË GRANTIT**

(bashkëlidhur)